



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 145, datë 11.3.2022

P Ë R

**PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN  
E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE NË BASHKITË  
SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 662 442 555 (një miliard e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy milionë e katërqind e dyzet e dy mijë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit,

banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara në bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë e Krujë, sipas detajimit të mëposhtëm:

- a) Për Bashkinë Shijak, në masën 107 863 248 (njëqind e shtatë milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tetë) lekë;
  - b) Për Bashkinë Kamzë, në masën 23 600 000 (njëzet e tre milionë e gjashtëqind mijë) lekë;
  - c) Për Bashkinë Kavajë, në masën 52 958 153 (pesëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë;
  - ç) Për Bashkinë Krujë, në masën 1 478 021 154 (një miliard e katërqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e njëzet e një mijë e njëqind e pesëdhjetë e katër) lekë.
2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, nga bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë, në masën 997 465 533 (nëntëqind e nëntëdhjetë e shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e pesëqind e tridhjetë e tre) lekë, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para, në bazë të aktekspertizave të thelluara, sipas detajimit të mëposhtëm:
- a) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 64 717 949 (gjashtëdhjetë e katër milionë e shtatëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e nëntë) lekë;
  - b) Bashkisë Kamzë i transferohet fondi, në masën 14 160 000 (katërmëdhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë;
  - c) Bashkisë Kavajë i transferohet fondi, në masën 31 774 892 (tridhjetë e një milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë;
  - ç) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 886 812 692 (tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë.
3. Efekti financiar, për vitin 2022, përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet bashkive Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rindërtimit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte që duhen rindërtuar nga e para.

4. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Shijak, Kamzë, Kavajë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ARBEN AHMETAJ**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI  
DHE MINISTËR I SHËTETIT PËR RINDËRTIMIN  
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

**ARBEN AHMETAJ**

NR.PROT.1231/I  
DATË 11.3. 2022

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I  
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E  
REFORMAVE  
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË  
BASHKIVE SHIJAK, KAMZË, KAVAJË DHE KRUJË  
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjell AGAÇI**

